



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Korrik 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Korrik 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e radhës pasqyrohen aktivitetet për muajin korrik 2021)

Mbahet takimi i Grupit punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, i udhëhequr nga kryesuesi i këtij komisioni, Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës.



Në këtë takim është diskutuar norma e prokurorëve të Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike në Prokurorinë Themelore të Prishtinës, ku anëtarët e grupit punues janë pajtuar që lidhur me normën, por edhe me njësitin në përgjithësi të bëhet një zgjidhje përmes Planit të ri strategjik të sistemit prokurorial.

Po ashtu, në këtë takim, Kryesuesi Veton Shabani, ka falënderuar për kontributin e dhënë si anëtar i këtij grupi, prokurorin Haxhi Derguti, i cili më 7 korrik 2021 do të arrijë moshën e pensionimit, me ç'rast puna e prokurorit Derguti në këtë grup ka marrë vlerësim maksimal nga anëtarët e tjerë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative, i udhëhequr nga kryesuesi Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, me ç'rast ka shqyrtuar një sërë pikash të parapara me rendin e ditës.

Fillimisht është shqyrtuar kërkesa për rishikimin e tarifave për angazhimet sipas detyrës zyrtare dhe lehtësimin e procedurave të kompensimit për avokatë,

kërkesë kjo, e cila iu ka drejtuar Këshillit Prokurorial të Kosovës nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Me këtë rast, anëtarët e komisionit janë pajtuar që ngritja e tarifave të bëhet në koordinim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ngaqë natyra e punës është e njëjtë.

Gjithashtu është kërkuar që Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel në bashkëpunim me Sekretariatit e KPK-së të bëjnë një kalkulim të shpenzimeve, të cilat do të krijohen me rastin e ngritjes së tarifave dhe Komisionit për Çështje Normative t'i propozojë ndryshimin e aktit sipas propozimeve për tarifa.



Në këtë takim është bërë finalizimi i draftit të Rregullores për Transferim dhe Avancim e Prokurorëve të Shtetit, qëllimi i së cilës është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për transferimin e përkohshëm, të përhershëm dhe për avancimin e prokurorëve të shtetit.

Po ashtu, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, Valdrin Krasniqi, ka prezantuar konceptdokumentet fillestare të organogramëve për Sekretariatit e KPK-së, Prokurorin e Shtetit, prokuroritë themelore dhe Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve, me anë të të cilave synohet fuqizimi i kapaciteteve profesionale dhe unifikimi i rregullimit të administratës së sistemit prokurorial, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Caktohen prokurorët për panelet hetimore

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, ka zhvilluar takimin e 201-të me radhë.

Në fillim të këtij takimi, anëtarët e KPK-së kanë propozuar emrat e prokurorëve që do të shërbejnë në panelet hetimore. Emrat e 13 prokurorëve të propozuar janë votuar për një mandat trevjeçar.

Më tej, KPK-ja ka miratuar kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës për të filluar

procedurat për avancimin e një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në këtë prokurori,



me ç'rast ka votuar për shpalljen e brendshme për avancim sipas kërkesës së lartcekur.

Në vazhdim është trajtuar Raporti i Komisionit për avancim të prokurorëve të Shtetit, ku është bërë avancimi i dy prokurorëve në Prokurorinë e Apelit dhe dy prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Në fund të këtij takimi është trajtuar Raporti i Komisionit për vlerësimin e performancës së 12 prokurorëve me mandat fillestar, raport ky, i cili është miratuar pjesërisht nga anëtarët e KPK-së.

Komisioni për Administrimin e Prokurorive zhvilloi takimin e radhës

Komisioni për Administrimin e Prokurorive i udhëhequr nga Kryesuesi, prokurori Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës.

Në fillim të takimit, është prezantuar analiza e ngarkesës me lëndë për periudhën janar - mars 2021 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020.



Lidhur me standardizimin e politikave në trajtimin e rasteve PPP dhe regjistrave tjerë si dhe monitorimin e aplikimit të formave të shkresave nga ana e prokurorëve, Komisioni u pajtua të realizojë vizita

nëpër prokurori për adresimin e çështjeve të lartcekura.

Po ashtu, gjatë këtij takimi u themelua grupi punues për inspektimin e furnizimit me material shpenzues, regjistrim të pasurisë dhe zbatimin e rregullave për qasjen në objekte të sistemit prokurorial nga palët dhe personat zyrtar, i cili do të hartojë Raport dhe të njëjtin do ta prezantojë në Komision.

Në fund të takimit Komisioni u njoftua lidhur me raportimin për herë të parë të kryeprokurorëve përmes formave të hartuara nga komisioni.

Kryesuesi i KPK-së, Maloku, takoi Kryesuesin e KGJK-së, Zogaj

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, është pritur në takim nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, me ç'rast kanë bashkëbiseduar për zhvillimet e përbashkëta brenda sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë për agjendat e përbashkëta.



Të dy krerët e sistemit të drejtësisë shprehën gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar për fuqizimin dhe avancimin e zbatimit të ligjit në kuadër të kompetencave të tyre përkatëse, për të sjellë ndryshimet e duhura në sistemin e drejtësisë.

Nga ana tjetër, Kryesuesi i KPK-së ka uruar Kryesuesin e KGJK-së për detyrën e re, duke shprehur bindjen se do të shtyjë përpara shumë procese të rëndësishme për sistemin e drejtësisë në Kosovë në përgjithësi dhe atë gjyqësor në veçanti.

Në fund të takimit, Kryesuesi i KGJK-së, Zogaj, ka falënderuar Kryesuesin e KPK-së, Maloku, për vizitën dhe diskutimet e zhvilluara në funksion të ndikimit pozitiv të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të drejtësisë.

Mbahet takimi i tretë i Komitetit Drejtues të projektit EUKOJUST

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, sot ka kryesuar takimin e tretë të Komitetit Drejtues të projektit EUKOJUST.

Në fillim të takimit Kryesuesi Maloku falënderoi përfaqësuesit e projektit dhe të gjithë akterët e përfshirë në realizimin e aktiviteteve të deritanishme duke theksuar aktivitetet kryesore që janë zhvilluar në kuadër të këtij projekti në mbështetje të sistemit prokurorial gjatë këtij tremujori.



Takimi ka vazhduar më miratimin e Raportit të parë tremujor për realizimin e aktiviteteve të projektit ndërsa është prezantuar raporti i dytë tremujor për periudhën prill – qershor 2021.

Projekti EUKOJUST mbështet sistemin e drejtësisë, financohet nga Bashkimi Evropian, dhe implementohet nga Konsorciumi mes IRZ (Gjermani), CILC (Holandë) dhe Ministria e Drejtësisë e Kroacisë, qëllimi kryesor i të cilit është reformimin e sistemit të drejtësisë në linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

U mbajt takimi i radhës i Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL

Është mbajtur takimi i tridhjetekatër i Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL, në të cilin ishin të pranishëm edhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, si dhe përmes videokonferencës morën pjesë përfaqësues nga Ambasada Norvegjeze në Prishtinë, Këshilli i Evropës në Prishtinë, Ministria e Drejtësisë, ekspertë të huaj dhe vendorë.



Në këtë takim u prezantua drafti i Raportit të Progresit të Projektit SMIL për periudhën janar-qershor 2021, i cili edhe u aprovua si dhe të arriturat kryesore të projektit për këtë periudhë.

Gjatë këtij takimi u vlerësua puna e bërë deri tani, me theks të veçantë - largimi i regjistrave manualë nga përdorimi në gjykata dhe prokurori.

Një e arritur tjetër e rëndësishme për këtë periudhë, u tha, se është edhe nënshkrimi i kontratës së përbashkët ndërmjet KPK-së dhe KGJK-së për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejme të SMIL-it, kontratë kjo, e cila ka hyrë në fuqi që nga data 1 maj 2021 dhe do të zgjasë tre vjet.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Në kuadër të aktiviteteve intensive që janë zhvilluar gjatë muajit korrik nga ana e SKPK-së, është mbajtura e takimit të Komitetit të Auditimit për tremujorin e dytë 2021, përgatitja e Raportit gjashtëmujor në NJQHAB, ofrimi i mbështetjes për hartimin e Raportit për analizimin e implementimit të strategjisë së sistemit prokurorial dhe koordinimi i aktiviteteve të finalizimit të projektit holandez, CILC.

Pastaj janë ofruar informatat e kërkuara nga projekti EUKOJUST për aktivitetet që kanë të bëjnë me vlerësimin gjinor të sistemit prokurorial në Kosovë, si është koordinuar organizimi i trajnimit "Menaxhimi i ndryshimit", në bashkëpunim me IRZ-në, im organizuar për shefat e shkrimoreve dhe zyrtarët financiarë lidhur me komunikimin e brendshëm.

Nga ana tjetër ka vazhduar edhe procesi i hartimit të Raportit analitik 2013-2020 të Mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike dhe është mbajtur një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese lidhur me organizimin e administratës.

Në kuadër të mbështetjes së aktiviteteve të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve janë

realizuar takime pune, në të cilat kemi vazhduar procesi i vlerësimit dhe notimit të performancës së prokurorëve, në kuadër të procesit të dytë për vitin 2021, në të cilin do të vlerësohen tetë prokurorë të përhershëm.

Po ashtu ka filluar grumbullimi dhe administrimi i të gjitha burimeve të informacionit për realizimin e procesit të tretë dhe të katërt të vlerësimit të performancës së prokurorëve, si dhe është krijuar një mekanizëm për sigurimin e burimeve të informacionit lidhur me të dhënat për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Këto burime të siguruara nga Zyra e Koordinatorit për sekuestrim dhe konfiskim do të shfrytëzohen në vazhdimësi për realizimin e procesit të vlerësimit të indikatorit konkret në kuadër të procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve.

Nga njësitë organizative të SKPK-së janë përgatitur raporte të ndryshme, përfshirë raportin e kërkuar nga kryesuesi i Komisionit për zgjedhjen e Drejtorit të NJSHPP-së lidhur me precizimin e saktë se kush nga kandidatët i plotëson kushtet e konkursit dhe konstatimin e Komisionit, si dhe është ofruar mbështetje në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Nga Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme është raportuar në Thesar për obligimet e muajit qershor 2021 dhe për obligimet kontraktuale, si dhe janë zhvilluar takime në Prokurorinë Themelore të Prizrenit, Gjiçanit, Prishtinës dhe Ferizajt, lidhur me proceset e punës.

Gjithashtu është përgatitur Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2021 dhe është raportuar në Departamentin e Buxhetit në MFPT lidhur me progresin fizik dhe financiar për periudhën prill-qershor 2021 përmes sistemit të PIP-it, si dhe është bërë identifikimi i sistemit të pasurive në raportin e asgjësimit.

Me ekspertët e angazhuar në projektin EUKOJUST janë bërë vizita në Prokurorinë Themelore të Ferizajt dhe Mitrovicës, me qëllim të vlerësimit të infrastrukturës dhe përcaktimit të nevojave për avancim, kurse në bashkëpunim me përfaqësuesit e kontraktorit të projektit SMIL është bërë testimi i modulit të arkivimit të lëndëve (arkivit aktiv dhe pasiv). Ndërkohë ka pasur diskutime me përfaqësuesit e këtij projekti lidhur me mbështetjen në finalizimin e Rregullores për administrimin e procesit të punës në sistemin prokurorial përmes SMIL-it dhe përgatitjen e një broshure për fushën e TI-së.

Ndër zhvillimet e tjera të sektorit të teknologjisë veçojmë mbajtjen e takimit me përfaqësuesit e Administratës Tatimore të Kosovës, ku është diskutuar shkëmbimi elektronik i të dhënave në mes të sistemit të tyre me SMIL, përkatësisht dorëzimin e kallëzimeve penale në mënyrë elektronike në prokurori dhe përgatitjen e raportit të ngarkimit të lëndëve për secilin prokuror për Prokurorinë Themelore të Prishtinës për periudhën janar-maj 2021, si dhe janë bërë përgatitjet për implementimin e shpërndarjes automatike të lëndëve në SMIL, si dhe:

- Është bërë publikimi i versionit të ri të sistemit SMIL, ku janë bërë përditësime në ndërlidhjen me Polici (prani i rastit të PK-së brenda një rasti ekzistues) dhe ndërlidhjes me gjykata si dhe janë përmirësuar një numër i gabimeve të raportuara nga tereni;
- Është përgatitur procedura e publikimit online të raportit statistikore i cili gjenerohet nga SMIL-i;
- Është funksionalizuar në tërësi sistemi për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve përfshirë edhe modulën e trajnimeve të prokurorëve;
- Është prezantuar drafti i parë i projektpropozimit për fazën tranzitore të SMIL-it, i cili do t'i dërgohet Ambasadës Norvegjeze për mbështetje për periudhën 2022 – 2025 në vlerë prej 1 milion eurosh për KPK-në dhe KGJK-në;
- Është përgatitur Raporti i punës për periudhën janar-qershor 2021 të Projektit TIK/SMIL për implementimin e aktiviteteve si dhe shpenzimi i buxhetit;
- Është funksionalizuar sistemi elektronik i testimit online, i cili do të përdoret nga kandidatët të cilët kanë aplikuar për pozitën e Prokurorit të Shtetit;
- Është mbajtur takimi i Bordit të Projektit TIK/SMIL dhe
- Në bashkëpunim me stafin e Policisë së Kosovës është bërë testimi i dërgimit – pranimit të rasteve nga moduli i hetimeve përmes sistemit elektronik. Gjatë muajit vijuese pritet që testimi të zgjerohet në të gjitha regjionet e Kosovës.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Aktivitetet e zhvilluara në korrik nga Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë kanë qenë të përqendruara në hartimin e Raportit për gjashtëmujorin e parë të punës së PSH-së, hartimin e Raportit analitik për rastet e dhunës në familje për periudhën 2019-2020 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, hartimin e Raportit për normën orientuese të prokurorëve për periudhën janar-qershor 2021, mbështetjen e procesit të rekrutimit, transferimeve dhe avancimeve të prokurorëve përmes zyrtarëve të caktuar nga KPK-ja për realizimin e këtyre proceseve, në përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave në dosjet fizike dhe elektronike të prokurorëve, përgatitjen e raportit për ngarkesën me lëndë të prokurorive në departamente sipas kërkesës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive, pjesëmarrje në takimin e Komisionit për Administrimin e Prokurorive, përgatitjen e komenteve për kompaninë e cila zhvillon SEMDP-në lidhur me kërkesat që janë parashtruar për përmirësim të pjesëve dhe dokumenteve të ngarkuara në databazë, përgatitjen e raportit informues lidhur me aktivitetet e realizuara nga ZMAVP/NJSHPP, të përcaktuara me Planin strategjik të sistemit prokurorial 2019-2021, përgatitjen e shënimeve lidhur me numrin e prokurorëve sipas strukturës etnike dhe gjinore për periudhën 2018-2021, sipas kërkesës së donatorëve, pjesëmarrjen në takimin për diskutimin e Draftitregullore për menaxhimin e procesit të punës përmes SMIL-it në sistemin prokurorial, përkatësisht modulën e raporteve që gjenerohen nga SMIL-i, përgatitjen e shënimeve dhe tabelën përkatëse për raportin infografik për tremujorin e dytë të vitit 2021 për webportalin e sistemit prokurorial, përgatitjen e informatave në kompetencë të ZMAVP-së për mekanizmat e brendshëm të sistemit prokurorial në mbështetje të proceseve të punës që janë zhvilluar gjatë muajit korrik, si dhe angazhimet e tjera për përmbushjen e obligimeve ligjore në kuadër të ZMAVP-së.

Gjithashtu nga Zyra për Statistika janë grumbulluar të dhëna për punën e 12 prokurorëve, të cilët iu nënshtruan procesit të vlerësimit, me anë të të cilave ka përgatitur raporte individuale sipas kërkesës së Komisionit për vlerësim të performancës të prokurorëve.

Po ashtu ka përgatitur raportet statistikore për: punën e prokurorive themelore dhe Prokurorisë Speciale, për tremujorin e dytë dhe gjashtëmujorin e parë të

vitit 2021, sipas llojeve të raporteve: kryes madhorë (PP); kryes të mitur (PPM); kryes të panjohur (PPP), si dhe informatat për rastet e ndryshme penale, me të cilat pretendohet se janë kryer veprat penale (PPN); ndihma juridike ndërkombëtare (NJNI); rastet për të cilat aplikohen procedurat alternative; Raportin statistikor për punën e Prokurorisë së Apelit; Raportin statistikor për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; Raporte statistikore për veprat karakteristike-Mekanizmi përcjellës për harmonizimin e të dhënave statistikore sipas grupeve të veprave penale: armët; narkotik-drogat, krimi të organizuar, korrupsion, trafikim të qenieve njerëzore, kontrabandë të migrantëve, shpëlarje parash; krime ekonomike (sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë); nxitje dhe urrejtje nga neni 147 i KPK-së; raportet e veçanta statistikore: raportet statistikore për rastet që kanë të bëjnë me raportimet për integritet evropian, MIE; raportet statistikore sipas kërkesës së DASH-it dhe raporte statistikore për veprat penale QNJ për Koordinatorin Nacional.

Po ashtu janë përgatitur raportet për gjendjen numerike të rasteve për muajin korrik për prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale, atë të Apelit sipas regjistrave; raportet për ngarkesën e prokurorëve me lëndë, si dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre. Gjithashtu ka përgatitur përgjigje në tri kërkesa nga Zyra për Komunikim Publik, një informatë nga Zyrtarja për Integritet Evropian dhe informata për Drejtorin e NJSHPP-së dhe sipas kërkesave të koordinatorëve kombëtarë për luftimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, krimeve ekonomike dhe kibernetike.

Nga ana tjetër kanë filluar diskutimet dhe procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për hartimin e Programit Trajnues 2022, me ç'rast u mbajt një takim me kryeprokurorë nga regjionet e ndryshme të Kosovës, në të cilin u diskutua për identifikimin e metodologjisë trajnuese, që së bashku me indikatorët e tjerë do të jetë përcaktuese për Programin Trajnues për vitin 2022.

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ-in – Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative, në kuadër të Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme organizoi trajnimin online me temë: “Procedura administrative lidhur me kërkesat nga lëmi i marrëdhënieve të punës, veçmas masat disiplinore”. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli themelor dhe bashkëpunëtorët profesionalë.

Gjithashtu, në Durrës të Republikës së Shqipërisë, financuar dhe mbështetur nga GIZ-i dhe Ministria e

Punëve të Jashtme e Norvegjisë, u organizua tryeza regjionale për trajnuesit nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë të akademive dhe institucioneve trajnuese të regjioneve të Ballkanit Perëndimor me temë: “Pastrimi i parave”. Tryezën e udhëhoqi eksperti i lartë ndërkombëtar nga Mbretëria e Bashkuar, Anthony Hooper, në kuadër të cilës u zhvillua kurrikula trajnuese e përbashkët regjionale që do të përdoret nga të gjitha institucionet trajnuese në regjion. Pjesëmarrësi në këtë tryezë ishin nga institucionet trajnuese nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë Veriore, Republika e Malit të Zi dhe Republika e Shqipërisë.